

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët–Valdete Daka, kryetare, Nesrin Lushta e Avdi Dinaj-anëtar, me bashkëpunëtorën profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit I. G. nga komuna e Lipjanit, për shkak të veprës penale shmangja nga sigurimi i mjeteve të jetesës nga neni 213.par.1.të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.292/2013 të datës 17.08.2015. dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAM.nr.53/2015 të datës 09.12.2015., në seancën e mbajtur më 14.07.2016., mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit I. G. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.292/2013 të datës 17.08.2015. dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAM.nr.53/2015 të datës 09.12.2015.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.292/2013 të datës 17.08.2015. i dënuari I. G. është shpallur fajtor për veprën penale shmangja nga sigurimi

i mjeteve të jetesës nga neni 213.par.1.të KPK dhe është gjykuar me dënim me kusht me të cilin i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale. Është urdhëruar që ti paguaj mjetet e jetesës si dhe detyrimet e papaguara në lartësi prej 10.300 euro, për periudhën kohore nga muaji korrik 2011 deri në gusht te vitit 2015. Po ashtu është obliguar të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Në procedurën ankimore me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAM.nr.53/2015 të datës 09.12.2015. ankesa e mbrojtësit të dënuarit është refuzuar si e pabazuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve mbrojtësi i të dënuarit, avokati S. K. nga Lipjani, ka paraqitur kërkesë për mbrojtën e ligjshmërisë, për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga aktakuza.

Prokurori i shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.91/16 të datës 07.06.2016. ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesë pretendohet se ligji penal është aplikuar gabimisht, si rrjedhojë e vërtetimit të gabuar të faktit se i dënuari ka paguar mjetet të jetesës për vajzat e tij F.1 dhe F. G. 2 ndërsa për ish bashkëshorten e tij F. D. ky obligim ka pushuar që nga janari i vitit 2013. kur ajo ka filluar të bashkëjetojë me personin tjetër, andaj me aplikimin e drejt e ligjit penal, i dënuari duhej të lirohej nga aktakuza.

Gjykata Supreme i vlerësojë këto pretendime, pra, edhe faktet e pagesës ose mos pagesës së mjeteve të jetesës për ish bashkëshorten dhe dy vajzat e të dënuarit, sepse kjo ndërlihet me aplikimin e drejt të ligjit material, dhe me këtë rast gjeti se pretendimi nuk është i bazuar. Kjo për arsye se, siç del nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimet e kundërshtuara, edhe vet i dënuari ka pranuar se nuk ka bërë pagesën e rregullt e as të tërësishme të këtyre mjeteve sepse nuk ka pas mjete të mjaftueshme as për vete (nga jetuar nga ndihma sociale), që nuk e liron nga obligimi i cekur ligjor, për arsye se poqëse kanë ndryshuar kushtet e tij materiale, do të duhej të merrej vendim në procedurën civile me të cilin shuma e obligimit dhe vet obligimi ndaj ish anëtarëve të familjes së tij po ashtu kishte për tu ndryshuar. Në anën tjetër, gjykata e shkallës së parë si dhe ajo e shkallës së dytë kanë vlerësuar faktin e bashkëjetesës së ish bashkëshortes së të dënuarit F. D. me personin tjetër dhe kanë gjetur se i dënuari ka paraqitur padi për ndryshimin e alimentacionit por ky kontest nuk ka përfunduar dhe nuk ekziston vendimi i formës së prerë i gjykatës civile për ndërprerjen e alimentacionit. Duhet te ceket se kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë i është bashkëngjitur aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.58/2013 i datës 03.11.2015. (i cili e ka marrë formën e prerë më datën 19.02.106.) me të cilin është miratuar kërkesëpapia e dënuarit dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës së qarkut në Prishtinë C.nr.224/2010 i datës 09.06.2011. ashtu që detyrimi i të dënuarit për alimentacion ndaj F. D. pushon nga muaji janar i vitit 2013., por ky aktgjykim nuk ka qenë i formës së prerë në kohën e marrjes së aktgjykimin penal të shkallës së dytë, pra, të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAM.nr.53/2015 të datës 09.12.2015. në këtë çështje penale dhe nuk ka mundur të ndikojë në vendimmarrje, sidomos në vendimmarrje për fajësinë e të dënuarit.

Andaj, me shpalljen fajtor e të dënuarit për veprën penale për të cilën është akuzuar nuk është shkelur ligji penal, siç pa bazë pretendohet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u konsiderua e pabazuar dhe konform nenit 437. të KPPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml.nr. 130/2016, më 14.07.2016.

Proçesmbajtësja,  
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,  
Valdete Daka